



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUÇOVË

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT :

“Mbrojtje nga gërryerjet e rrugës kryesore në përroin e Lumasit, krahu i majtë pranë Urës së Lumasit, ndërtimi i tre urave në përroin e Saraselit, Belesovës dhe Mëndrakës si dhe ndërtimi i rrugës lidhëse”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi 45221100-3 (punime ndërtimi për ura),

Kodi 45233120-6 (punime ndërtimi për rrugë),

Kodi 45246100- 4 (ndërtim i mureve lumore)

VLERA E FONDIT LIMIT :

55 426 814,75 (pesëdhjetë e pesë milion e katërqind e njëzetë e gjashtë mijë e tetëqind e katërmëdhjetë presje shtatëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kuçovë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë :

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë :

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 3....

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 duke mbajtur në konsideratë dhe përcaktimet e Ligjit Nr 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, pranë njësive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e ti sipas QKB-së.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Për Taksat Lokale

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9 përcaktohet se :

Në taksat vendore përfshihen :

1. Taksa vendore mbi biznesin e vogël.
2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore.
3. Taksa e fjetjes në hotel.

4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.
5. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.
6. Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve.
7. Taksa për zënien e hapësirave publike.
8. Taksa e tabelës.
9. Taksa të përkohshme.

Në nenin 14 po këtu, përcaktohet se : “1. Taksa paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiscal”.

Bazuar mbi sa më sipër kërkesa e autoritetit kontraktor për pagesën e taksave lokale për vitin 2023 është në përputhje me ligjin 9632 datë 30.10.2006 ”Për sistemin e taksave vendore”.

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron minimale vjetore për tre vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 80% e fondit limit të kontratës që prokurohet.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :

Autoriteti kontraktor, në përcaktimin e vlerës së xhiros minimale vjetore (dhe konkretisht jo më pak se 80% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet) ka mbajtur në konsideratë nenin 43 pika 2 gërma b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku shprehimit thotë se :

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare .

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

- a) dyfishin e vlerës së përlllogariturtë kontratës ose lotit¹, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
- b) **vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;**
- c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros qëmund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të japin informacione në bilancet e tyre vjetore për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
 - b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 180 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.
- Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e një kontrate të ngjashme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm :

- Për kontrata për punë publike të realizuar me institucione shtetërore kërkohen:

- a) *Kontraten/at e Sipërmarrjes,*
- b) *Situacion përfundimtare të objektit,*
- c) *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës përkatëse,*
- d) *Akt Kolaudimi*
- e) *Faturat tatimore*
- f) *Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm dhe/ose përfundimtare*

- Për kontrata për punë publike është realizuar me subjekte private kërkohen:

- a) *Kontraten/at e Sipërmarrjes,*
- b) *Situacion përfundimtare të objektit,*
- c) *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës përkatëse.*
- d) *Akti i Kolaudimit*
- e) *Faturat tatimore,*

f)Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm dhe/ose përfundimtare

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë jo më e vogël se **40 %** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël **180%** të vlerës së fondit limit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë :

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- N.P – 1 A (Punime gërmimi në tokë)
- N.P – 5 A (Punime nëntoksore , ura e vepra arti)
- N.P - 9 B (Punime për mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime)

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- N.S - 9 A Punime Struktore Speciale
- N.S - 18 A Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjise, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në Nr.42, datë 16.01.2008).

Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- **Kategoria NP-1 A (Punime gjurmimi në tokë)**

Konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet, vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Referuar zërave të preventivit dhe sasisë së punimeve të cilat përfshijnë gjurmimet për Gjurmime gjithsej me makineri ne prani uji per temel në sasinë 400 m³, Gjurmim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m³ ne kanale gjeresi deri 2 m, prani uji ~1m, kategoria III, me shk ne toke per devijim lumi në sasinë 1500 m³, Gjurmim temel, shkemb bute,h=2.5m,makineri, prani uji (germim shkemb i bute per themele per ballnat, shpatullat e muret mbajtes) në sasinë 285 m³, Gjurmim temel, shkemb bute,h=2.5m,makineri, prani uji (germim shkemb i bute per themele per ballnat, shpatullat e muret mbajtes në sasinë 355 m³etj, operatori ekonomik duhet të disponojë

këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

N.P – 5 A (Punime nëntoksore , ura e vepra arti)

Konsiderohen. Ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntoke që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi “goma” ose mbi “hekur”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele.

Referuar objektit të prokurimit, njësia e prokurimit gjykon se licënca e mësipërme përputhet plotësisht.

N.P - 9 B (Punime për mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime)

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta ose në rrjet, si do që të jenë realizuar, të nevojshëm për sistemimin e rrjedhjes së ujërave natyrore ose artificiale si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra, të kompletuara me punimet lidhëse të nevojshme.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar kanale lundruese, grykëderdhjet e lumenjve, konsolidimin e strukturave të anëve të lumenjve dhe përrenjve, argjinatura të llojeve të ndryshme, sistemimin dhe vendosjen e regjimit hidraulik të ujërave sipërfaqësore të veprave të diafragmave të argjinaturave dhe qëndrueshmërisë së shpateve.

Njësia e prokurimit sqaron se qëllimi i autoritetit kontraktor është Mbrojtje nga gërryerjet e rrugës kryesore në përroin e Lumasit, krahu i majtë pranë Urës së Lumasit, ndërtimi i tre urave në përroin e Saraselit, Belesovës dhe Mëndrakës si dhe ndërtimi i rrugës lidhëse. Duke analizuar preventivin e punimeve, parashikohen zëra të konsiderueshëm për mbrojtjen lumore si Germime gjithsej me makineri ne prani uji per themel, Germim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, prani uji ~1m, kategoria III, me shk ne toke per devijim lumi, Mbushje me argjile pas murit te argjinatures me gabiona, Shtrese e varfer betoni mbrojtje dhe inkastrim gabioni me beton C 16/20, Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 2x1x1 m.

Për sa më sipër, licënca e mësipërme është në përputhje me objektin e prokurimit, si dhe nga mbledhja e shumatorës së zërave ofertuesit duhet të disponojnë këtë kategori në nivelin B nga 21 deri në 50 milion lekë për këto punime për shkak se vlera e tyre, është në kufirin e përcaktuar më sipër.

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

N.S - 9 A Punime Strukturore Speciale

Konsiderohet ndërtimi i objektit i destinuar për transmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuara për t'u ndërtuar në terrene rezistonte dhe jo të deformueshme, por me parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotëve të çfarëdolloj tipi, të themeleve nëntokësore me pilotë ose me mure mbajtëse, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale, përfshirë edhe marrjen e kampioneve për analiza laboratorit nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve. Impermeabilizzazione dhe konsolidimin e terreneve.

Në preventiv janë parashikuar punime si Mur Beton C 20/25 për shpatullat e urës, Soletone b/arme C 30/35 për urën, Shtrese zhavori lumi t=30cm, përhapur e ngjeshur me makineri për përroin e Saraselit. Të njëjta punime janë parashikuar edhe për urën mbi përroin Belesovë si dhe mbi Përroin e Mëndrakës

Kërkesa që operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë licencën NS 9 A është një kërkesë në përputhje dhe vëllim të plotë me objektin e prokurimit dhe njëkohësisht garanton autoritetin kontraktor për zbatimin me sukses të kontratës dhe në kohë.

NS - 18 A (Punime Topogjeodezike)

Konsiderohet zbatimi i rievimeve topografike special që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta Në këtë objekt përfshihen edhe punime si piketimi, rievime të ndryshme topografike në sisteme koordinative të ndryshme caktimi i kuotave të kërkuara nga projekti, azhornime të ndryshme dhe lidhjet me sistemet koordinative relative dhe absolute. Për këtë arsye operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë :

1 (një) Inxhinier Ndërtimi

- 1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licensën e operatorit ekonomik ofertues .

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë :

Për secilin pjestar te stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë kontrate pune e vlefshme, diplomë, librezë pune dhe CV, (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi)

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Në rastin konkret synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë staf të kualifikuar teknik për kryerjen e punimeve objekt kontrate.

Në nenin 8 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” parashikohet se “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.” Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane. Me materiale dhe produkte ndërtimi kuptohet çdo produkt i prodhuar për t'u përfshirë në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit.”

Sa më sipër, në interpretim të dispozitave të mësipërme, zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga personat të pajisur me licencë të cilët njëherazi mbajnë përgjegjësi për realizimin e punimeve në përputhje me kushtet e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Lidhur me disponueshmërinë e Inxhinierëve të mësipërm, njësia e prokurimit gjykon se për sa kohë që autoriteti kontraktor në preventivin e punimeve ka parashikuar punime të një natyre në të cilën shfaqet e nevojshme disponueshmëria i një Inxhinier ndërtimi, Hidroteknik, Gjeolog si dhe Topograf parë kjo në raport edhe me pikat dhe kategoritë përkatëse të licencës së kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, dhe referuar volumeve të punimeve të parashikuara në preventivin dhe në projektin përkatës, kriteri i mësipërm është në përputhje dhe proporcion me volumin e kontratës, si dhe në raport me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve të parashikuar, vlerën dhe natyrën e saj, është një kërkesë në përpjestim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

➤ **Inxhinier Ndërtimi** **1 (një)**

Nga zërat e preventivit dhe natyra e objektit të prokurimit dhe në zbatim të VKM 629 datë 13.05.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” janë përcaktuar numri i punonjësve dhe stafi i kualifikuar me licencë ose dëshmi të lëshuara nga autoritetet e përcaktuara me ligj. Kërkesa për një inxh. Ndërtimi që të jenë në licencën e shoqërisë është vendosur në zbatim të Kodit të Punës, kohëzgjatja javore e punës 48 orë për një periudhë të gjatë pune (afati i realizimit të punimeve të kontratës është 4 muaj, në zbatim të VKM nr.42 datë 16.01.2008 Për Miratimin e Rregullores për Kriteret dhe Procedurat e Dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që Ushtrijnë Veprimtari Ndërtimi”, pika II :c) Autoritetet kontraktore, në përcaktimin e grafikëve dhe afateve për përfundimin e punimeve të ndërtimit, në dokumentet e tenderit të prokurimit dhe në kontratën e zbatimit të veprave publike, ndërtimore, detyrohen të llogarisin kryerjen e punimeve, për periudhën 4 mujore, për ndërtimin e objekteve .

Specialiteti i inxhinierëve të ndërtimit është vendosur në zbatim të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 Kreu IV “Drejtuesi Teknik i shoqërisë dhe pa pajtueshmëria me këtë detyrë ”.

Synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë staf të kualifikuar teknik (inxhinier ndërtimi të cilët janë njëherazi dhe drejtues teknik) për kryerjen e punimeve në përputhje me kohëzgjatjen e parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe njëherazi në përputhje me turnet e parashikuar nga akti nënligjor në zbatim të ligjit. Në nenin 8 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Per Kontrollin Dhe Disiplinimin E Punimeve Te Ndertimit” parashikohet se “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.” Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane. Me materiale dhe produkte ndërtimi kuptohet çdo produkt i prodhuar për t'u përfshirë në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit.”

Duke analizuar preventivin e punimeve , dhe parë objektin e prokurimit i cili është “Mbrojtje nga gërryerjet e rrugës kryesore në përroin e Lumasit, krahu i majtë pranë Urës së Lumasit, ndërtimi i tre urave në përroin e Saraselit, Belesovës dhe Mëndrakës si dhe ndërtimi i rrugës lidhëse” dhe zërat përkatës në preventiv, del i nevojshëm që operatori ekonomik fitues duhet të disponoj një inxhinier ndërtimi.

➤ **Inxhinier Topograf/Gjeodet 1 (një)**

Inxhinier topograf kërkohet për çdo punë ndërtimi ku ka shtrim rrugësh, rikonstruksione ose ndërtim banesash, punime ndërtimi, gjermim kanali etj sepse ai merret me rilevimit e tokës, kuatot, profile tërthero dhe gjatësore, piketimet etj. Prania e topografit është e domosdoshme në terren për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë duke i dhënë garanci autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses.

➤ **Inxhinier Hidroteknik 1 (një)**

Duke analizuar objektin e kontratës, qëllimi i autoritetit kontraktor është zbatimi i punimeve me sukses dhe në kohë. Nisur nga volumet e punimeve, inxhinieri i mësipër është përgjegjës për udhëheqjen e punimeve si F.V. Tub pvc 100 m/m per kullimin e ujrave te shiut te vendosura ne mure per kullim, Tombino me tuba betoni Ø 1000, mbi shtrese betoni.

Bazuar edhe në specifikimet teknike të hartuar, në seksionin 2.12 është parashikuar largimi i ujrave nga punimet e gjermimit. Duke qënë se punimet për ndërtimin e urave konsiston në gjermime të ballnave, mbështetjeve dhe shpatullave në prezencë të ujit, kontraktori do të marrë të gjithë masat për eliminimin e ujrave në themele, sipas parashikimit të zërave të punës në projekt.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kërkesa për disponimin e një inxhinieri hidroteknik është i domosdosshëm dhe garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses.

➤ **Inxhinier Gjeolog 1 (një)**

Lidhur me kërkesën mbi disponimin si drejtues teknik të një ing. Gjeolog, referuar objektit të kontratës, ku ky i fundit shprehet se “Ing. Gjeolog është vendosur pasi, në objektin ku do të zhvillohet investimi do të hapen themelet për ndërtimin (e këmbëve) të tre urave në prezencë të

ujit do të duhet edhe mendimi i specializuar i këtij inxhinieri gjeolog si Drejtues Teknik në stafin e një shoqërie ndërtimi, e cila është e nevojshme për realizimin me sukses të punës, për sa kohë që ajo është në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Në seksionin 2.3 tek specifikimet teknike është parashikuar se gërmimi duhet të kryhet në përputhje me kuotat siç tregohet në vizatime. Kujdes i veçantë duhet të ushtrohet kur gërmohen seksionet për të mos hequr material përtej vijës së specifikuar në projekt dhe më pas duke shkaktuar rrezikshmëri për qendrueshmërinë e skarpatave. Në pikën 2.6 vërehet se ; gërmimet duhet të bëhen pa prezencë uji. Tabani i të gjithë gërmimeve duhet të nivelohet me kujdes. Çdo pjesë me material të butë ose mbeturina shkëmbi në taban duhet të hiqet dhe kaviteti që rezulton të mbushet me beton.

Në relacionin teknik është vënë në dukje gjendja ekzistuese mbi përroin e Saraselit, Belesovës dhe Mëndrakës. Në aksin rrugor ndërmjet fshatrave Pëllumbas dhe Belesovë kemi një urë ekzistuese të dëmtuar dhe jashtë funksionit, i cili bëhet i pakalueshëm në situata rreshjesh të dëndura apo situata emergjente.

Për sa më sipër, duke analizuar preventivin e punimeve, projektin, relacionin teknik si dhe specifikimet teknike, njësia e prokurimit gjykon se kërkesa për disponimin e një inxhinieri gjeolog është në përputhje dhe vëllim të plotë të objektit të kontratës dhe garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, I shoqëruar me dokumentat:

- Libreze pune;
- Kontrate pune e vlefshme;
- Diplomë.

2.3.5 Operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, për të paktën 3 (tre) muajt e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës si staf teknik punonjësit si më poshtë :

NR	EMËRTIMI	PUNONJËS
1	Saldator	2 (dy)
2	Karpentier	4 (katër)

3	Hekurkthyes	3 (tre)
4	Teknik ndërtimi	2 (dy)
5	Manovrator	4 (katër)
6	Shofer	4 (katër)
Totali 19 (nënttëmbëdhjetë)		

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve të mësipërm në përputhje me shtojcën 8 .

Përpara lidhjes së kontratës për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë :

Dëshmi kualifikimit të sigurimit teknik të cilat të jenë të lëshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, ***ose çertifikata ekuivalente të tyre (të vlefshme)***, kontrate pune e vlefshme, çertifikatat përkatëse si edhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për 3 (tre) muajt e fundit.

Për manovratorët/shoferët duhet të paraqitet Dëshmi e Aftësisë Profesionale (të vlefshme) lëshuar nga institucionet përkatëse. (Në rastet kur mjetet e kërkuar më poshtë janë me qera, atëherë plotësimi Për manovratorët/shoferët do të lejohet edhe nëpërmjet nënkontraktimit.

(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, mbështetës dhe të specializuar / kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale, apo certifikimet / kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime / kualifikime).

Per profesionet si me sipër, operatori ekonomik duhet te plotesoje tabelën si me poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni	Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Nr NIPT (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1				
2				

Argumentimi në lidhje me pikën 2.3.4. Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që

operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Njësia e prokurimit sqaron se të gjithë punonjësit e kërkuar si më sipër me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik apo certifikata ekuivalente të tyre, përkojnë me punimet sipas preventivit të publikuar në SPE, dhe konkretisht :

Për teknik ndërtimi 2 (dy) persona të pajisur me dëshmi aftësie profesionale 2 (dy) persona, nevojitet prezenca e tyre në kantier për “Mbrojtje nga gërryerjet e rrugës kryesore në përroin e Lumasit, krahu i majtë pranë Urës së Lumasit, ndërtimi i tre urave në përroin e Saraselit, Belesovës dhe Mëndrakës si dhe ndërtimi i rrugës lidhëse” duke garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses si punime për Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 2x1x1 m, Mur Beton C 20/25 per shtatullat e ures, Mur Beton C 20/25 per daljen e tombinos, etj.

Njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësish për zbatimin e këtyre zërave dhe konkretisht **teknik ndërtimi** 2 (dy) persona.

- **Karpentier 4 (katër)** janë të nevojshëm pasi në zërat e preventivit përfshihen punime betoni, kallëpet, shtresat dhe hekuri periodik ndërtimi, montimi i skelave për punimet në lartësi për ngritjen e urave etj.

Duke refuar dhe preventivit të punimeve, janë parashikuar punime si 3.333 Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 2x1x1 m në sasinë 380 m³ për ndërtim mbrojtje nga gërryerjet e rrugës Lumas-Vodëz afër urës së Lumasit,

Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 2x1x1 m në sasinë 1350 m³ për ndërtimin e rrugës që lidh fshatrat Belesovë dhe Mëndrakë. Specialistët e mësipërm do të shërbejnë edhe për montimin e skelerve të këmbëve të urës.

Nga sa më sipër argumentuar, njësia e prokurimit gjykon se kërkesa për disponimin nga ana e ofertuesve për 4 (katër) karpentier, është në përputhje me objektin e kontratës si dhe i shërben qëllimit të AK duke garantuar këtë të fundit për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

- **Hekurkthyes 3 (tre)** janë të nevojshëm pasi në zerat e preventivit përfshihen përpunimi dhe lidhja e hekurit të ndërtimit të këmbëve dhe shtratit të 3 urave.
- **Saldator 2 (dy)** janë të nevojshëm për saldimin, drejtimin, bashkimin e detaleve të ndryshëm, me prerjen e tyre, me bashkimin e objekteve të madhësive dhe formave të ndryshme duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- Për manovratorët 4 /shoferët 4 janë të nevojshëm për manovrimin e mjeteve të kërkuar në DST dhe konkretisht : Kamion vetshkarkues me kapacitet jo me te vogel 20t 2 copë, Kamion vetshkarkues me kapacitet jo me te vogel 10t 2 copë, Kamioncine me kapacitet mbajtes deri ne 3.5 t 2 copë, Eskavator me zinxhir 2 copë, Eskavator me zinxhir krahe gjate jo me pak se 23 m 1 copë, Eskavator me goma, Minieskavator / bobkat, Buldozer, Rul ngjeshes cilindrik me dhembe, RTV - Trasportier per mjete te renda.

2.3.6 Operatorët ekonomikë duhet te disponojnë 1 (një) punonjës me çertifikatë/ ose çertifikatë trajnimi si **“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”** të lëshuara nga nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara nga DPA (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose çertifikata ekuivalente të tyre (të vlefshme), si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërise për të paktën 3 muajt e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve të mësipërm në përputhje me shtojcën 8 .

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”* dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 *“Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”*. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri dhe përgatitje të posaçme për

vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilet janë të çertifikuar si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, janë të nevojshëm për të menaxhuar emergjencat gjatë punimeve dhe të sigurojnë mbrojtjen e shëndetit në punë.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 40 (dyzetë) punonjës *për të paktën 3 muajt e fundit*.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për tre muajt e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8 .

Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë :

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit, për periudhën **si më sipër**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **si më sipër**.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit,që

ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Referuar legjislacionit në fuqi, është përcaktuar se autoriteti kontraktues kërkon dëshmi për fuqinë punëtore me qëllim që të garantohet për realizimin me sukses të kontratës.

Si dhe referuar përmasave të kontratës që do të do të prokurohet, specifikimeve teknike, fondit limit, afatit të zbatimit të saj, si dhe kohëzgjatjes së parashikuar për realizimin e punimeve gjithësej 6 (gjashtë) muaj, njësia e prokurimit vlerëson se numri i punonjësve të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor në rastin konkret, garantohet për zbatimin e kontratës me sukses duke krijuar besueshmerinë dhe qëndrueshmëri të punonjësve tek operatorët ekonomik, si dhe duke mos sjellë vonesa në zbatimin e saj.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve të mësipërm në përputhje me shtojcën 8 .

2.3.8 Operatorët ekonomik ofertues duhet të jenë të çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, dhe konkretisht :

- ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë e vlefshme), ***ose ekuivalent***
- ISO 14001-2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor e vlefshme), ***ose ekuivalent***
- OHSAS 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit të sigurisë në punë), ***ose ekuivalent.***

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave

të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Për vetë natyrën e veçantë dhe delikate, dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet si dhe afatit për zbatimin e saj.

Kjo çertifikatë lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohet edhe çertifikata ekuivalente të tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë çertifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardin për menaxhimin e mjedisit për sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtëpërdrejtë në mjedis.

ISO (Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit) është një organizatë me anëtarësi e pavarur, jo-qeveritare dhe zhvilluesi më i madh në botë i Standardeve Ndërkombëtare, nga 163 vende të botës. ISO publikon më shumë se 19500 Standarde Ndërkombëtare, të cilat mbulojnë pothuajse çdo fushë industrie, nga teknologjia te siguria ushqimore, bujqësia e shëndeti. Në nivel botëror shoqëritë ndjekin adoptimin e standardeve të cilësisë me qëllim që të jenë të respektuar nga klientet e autoritetet shtetërore dhe të ndërtojnë bashkëpunim të qëndrueshëm me avantazhe reciproke.

➤ **ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalent**

Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të cilësisë, është standarti më i njohur që është publikuar ndonjëherë në nivel ndërkombëtar. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilën AK kërkon ta kryejë me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, preventivin dhe vlerën e saj, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij që të kërkojë çertifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, që përpos punimeve që do të kryhen nga operatorët ekonomikë ofertues, këto punime të kryhen me cilësi sipas çertifikatës ISO të mësipërme .

➤ **ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit” e vlefshme, ose ekuivalent**

Ky çertifikim shërben në lidhje me sistemet e menaxhimit mjedisor, me anë të së cilës garantohen mundësitë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një subjekti me synim parandalimin e dëmtimit të mjedisit, respektimin e legjislacionit vendas në lidhje me mjedisin dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Gjithashtu, ky çertifikim fokusohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të

subjektit, duke bërë të mundur të përmirësohet ndikimi i veprimtarisë së përgjithshme të subjektit në aspektin mjedisor .

Kjo certifikatë është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Referuar objektit të prokurimit në rastin konkret, njëzia e prokurimit e ka parë të nevojshme që shoqëritë të jenë të certifikuar nga organizata ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit të mjedisit sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi të, duke kryer një proces riaftësimi më pas të ambientit përreth ku do të kryhet investimi.

➤ **ISO 45001-2018** (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë) e vlefshme, *ose ekuivalent i saj*

Është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar që përcakton kërkesat për një sistem manaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë .

Kjo certifikatë garanton sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve që marrin pjesë gjatë një procesi prodhimi apo kryerjes së një veprimtarie apo pune publike e cila vë apo mund të vërë në rrezik shëndetin dhe jetën e punonjësve . Është e lidhur ngushtë dhe në përpjestim me objektin e kontratës, sipas parashikimeve të LPP.

Autoriteti kontraktor përpos punimeve që do të kryejë, kërkon që këto punime ti zhvillojë në përputhje dhe garanci të plotë me sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve .

2.3.9 Operatorët ekonomik ofertues për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet teknike si më mëposhtme :

Nr	Makineri dhe pajisje	Nr.	Njësia	Statusi
1	Kamion vetshkarkues me kapacitet jo më të vogël se 20t	4	copë	Në pronësi ose me qera
2	Kamion vetshkarkues me kapacitet jo më të vogël se 10t	3	copë	Në pronësi ose me qera
3	Kamioncine me kapacitet mbajtës deri në 3.5 t	2	copë	Në pronësi ose me qera
4	Eskavator me zinxhir	2	copë	Në pronësi ose me qera
5	Eskavator me zinxhir krahe gjatë jo më pak se 20 m	1	copë	Në pronësi ose me qera
6	Dumper kantieri	2	copë	Në pronësi ose me qera

7	Eskavator me goma	1	copë	Në pronësi ose me qera
8	Minieskavator / bobkat	1	copë	Në pronësi ose me qera
9	Buldozer	1	copë	Në pronësi ose me qera
10	Rul ngjeshes cilindrik me dhëmbë	1	copë	Në pronësi ose me qera
11	RTV - Transportier për mjete të rënda	1	copë	Në pronësi ose me qera
12	Moto gjenerator	2	copë	Në pronësi ose me qera
13	Saldatrice	1	copë	Në pronësi ose me qera
14	Betoniere kantieri	2	copë	Në pronësi ose me qera
15	Vibrues betoni	2	copë	Në pronësi ose me qera
16	Betoforma	200	m2	Në pronësi ose me qera
17	Moto pompe uji	2	copë	Në pronësi ose me qera
18	Kthyesë hekuri / bango hekuri	1	copë	Në pronësi ose me qera
19	Kokore	35	copë	Në pronësi ose me qera
20	Jelek	35	copë	Në pronësi ose me qera
21	Tabela sinjalizuese kantieri	8	copë	Në pronësi ose me qera
22	Komplet i ndihmes se shpejtë	2	copë	Në pronësi ose me qera

Për përmbushjen e kesaj pikës, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve të mësipërm në përputhje me shtojcën 8.

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjete dhe targa e tij.

Ne rast se operatori ekonomik nuk disponon mjet RTV – Transportues për mjetet e rënda mund të paraqesë kontratë bashkëpunimi të vlefshme për gjithë periudhën që zgjasin punimet.

- a) *Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik si dhe çertifikatën e transportit të mallrave (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) .*
- b) *Për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik si dhe çertifikatën e transportit të mallrave (të vlefshme), siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*

Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

- c) *Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.*
- d) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës përkatëse. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- e) *Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara më sipër do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak për skualifikim. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës .*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar ligjvënësi i jep të drejtën autoritetit kontraktor të kërkojë nga ana e operatorëve ekonomik dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve të ndërtimit dhe preventivit të hartuar nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Kuçovë, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve. Për realizimin e kontratës me sukses dhe në kohë autoriteti kontraktor kërkon garanci nga operatorët ekonomik ofertues të cilët duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme, gjithçka në funksion të zbatimit të kontratës.

Duke parë volume e punimeve, afatin për realizimin e saj, vlerën e kontratës, relacionin teknik është e nevojshme që operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se disponojnë mjetet e mësipërme për realizimin me sukses dhe në kohë të objektit të prokurimit .

Analizë të detajuar në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që kërkohen nga autoriteti kontraktor :

- Në lidhje me kamion vetëshkarkues 4 copë me kapacitet minimumi 20 ton dhe 3 copë me kapacitet mbajtës min 10 ton njësia e prokurimit është bazuar në preventivin e punimeve duke analizuar proceset e punës që do të zhvillohen të cilat janë të domosdoshëm prania e mjeteve të mësipërme për transportimin e të gjitha materialeve të ndërtimit pranë kantierit dhe më konkretisht, për ndërtimin e e urës pranë përroit të Saraselit për zërat Mbushje me zhavorr pas mureve e shpatllave në sasinë 465 m³, F. v. hekur betoni periodik Ø > 10mm në sasinë 13.4 ton, Transport element betoni dhe b/a me auto deri 30 km në sasinë 1448 ton.

Për ndërtimin e e urës pranë përroit të Belesovës për zërat Mbushje me zhavorr pas mureve e shpatllave në sasinë 650 m³, F. v. hekur betoni periodik Ø > 10mm në sasinë 13.4 ton, Transport element betoni dhe b/a me auto deri 30 km në sasinë 1276 ton.
disponueshmëria e mjeteve të sipërcituar garanton AK për zbatimin e kontratës me sukses.

Për ndërtimin e urës pranë përroit të Mëndrakës për zërat Mbushje me zhavorr pas mureve e shpatllave në sasinë 450 m³, F. v. hekur betoni periodik Ø > 10mm në sasinë 13.4 ton,

Si dhe për ndërtimin e rrugës që lidh fshatin Belesovë dhe Mëndrakë janë parashikuar punime si Shtrese zhavorr lumi t=30cm në sasinë 2,150 m², Cilindrim shtrese zhavorr t=15cm, me rul në sasinë 4,300 m², Mbushje me zhavorr pas murit mbrojtës të gabionit në sasinë 2,310 m³, Gabiona me rrjete teli të zinguar e gure kave 2x1x1 m në sasinë 1,350 m³, Transport element betoni dhe b/a me auto deri 30 km në sasinë 952 ton.

Nga proceset e punës të listuar si më sipër, si dhe duke u bazuar në grafikun e punimeve të ndërtimit ku është parashikuar për 6 muaj që të përfundoj investimi, njësia e prokurimit gjykon se ka parashikuar një numër minimal mjetesh me qëllim zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë. Volumet e punimeve parashikuar në preventiv janë të madhe dhe për rrjedhojë kërkohet që ofertuesit të disponojnë kapacitete teknike, të aftë për të zbatuar kontratën me rogorizitet.

- Në lidhje me Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton 2 copë, njësia e prokurimit sqaron se janë të nevojshëm për transportimin dhe sistemimin e materialeve të ndërtimit pranë kantierit dhe më konkretisht, për zërat në përmasa dhe volume më të vogla si F.V. Tub pvc 100 m/m per kullimin e ujrave te shiut te vendosura ne mure per

kullim, Boje vaji siperfaqe metalik (Lyerje 1 dore antiruxho + 2 duar boje vaji), Guardrail- N2 anesore me 2 valez. ne 1 ane , W2 + aksesor, Hidroizolim me emulsion dhe dy duar bitum ballnat e murat mbrojtese etj. Ky mjet është i favorshëm pasi mund të qarkullojë në çdo orar

- Në lidhje me Eskavator me zinxhir 2 copë, Eskavator me goma 1 copë, Minieskavator / bobkat, buldozier 1 copë njësia e prokurimit gjykon se duke analizuar preventivin e punimeve ku janë parashikuar punime gërmime në volume të mëdha, si dhe ku parashikohet ndërtimi i 3 urave, i mbrojtjes lumore dhe rikonstruksioni i rrugës lidhëse midis dy fshatrave Belesovë dhe Mëndrakë, disponimi nga ana e ofertuesve të mjeteve të mësipërm garanton AK për zbatimin në kohë të kontratës. Lidhur me mjetin buldozier shërben për sistemimin e shtresave të rrugës.

- Në lidhje me Eskavator me zinxhir krahë gjatë jo më pak se 23 m (në preventiv zëri 2.37/5b Gërmime gjithsej me makineri në prani uji për themel) për ndërtimin mbrojtje nga gërryerjet e rrugës Lumas Vodëz afër urës së Lumasit. Duke qenë se ura ekzistuese është e amortizuar dhe bazamenti i saj është me dy tombino, kalimi në anën tjetër të urës të një mjeti me tonazh të lartë për gërmimet e skarpatave nuk është i mundur, dhe ku lumi në periudhën që parashikohet të lidhet kontrata do ketë prurje, nevojitet një mjet i cili të jetë me krahë pothuajse sa gjatësia e urës e cila është afërsisht 22.71m. Qellimi i AK i zbatimi i punime me sukses, dhe disponimi i mjetit të më sipër garanton këtë të fundit për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë në përputhje me zërat e preventivit. Duke qenë se i njëjti proces pune do të kryhet për bazamentet dhe këmbët e urës për të 3 urat si dhe për mbrojtjen lumore, duke marrë parasysh faktin se investimi do të kryhet në terren të vështir, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i mësipërm i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor dhe nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme .

- Në lidhje me Rul ngjeshes cilindrik me dhëmbë.
Njësia e prokurimit sqaron se mjeti Kërkohen për ngjeshjen e shtresave rrugore dhe asfaltike.
Disponimi i mjeteve të mësipërm nga ana e ofertuesve garanton autoritetin kontraktor që zbatimi i punimeve të kryhet në kohë dhe në përputhje me grafikun e punimeve.

- Në lidhje me RTV - Transportier për mjete të rënda, NJP sqaron se është i domosdoshëm për transportimin e mjeteve me zinxhir pranë kantierit të ndërtimit.

- Motogenerator; prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit konkretisht në momente kur nuk kemi energji elektrike, si dhe në një pjesë të madhe të zonës ku do të kryhet investimi është i pamundur furnizimi me energji elektrike pranë kantierit të ndërtimit.
- Depozite uji 5000 litra (2 copë); janë të nevojshme në rastin kur ka mungesë të furnizimit me ujë, kur duhet bërë llaçi, ujitja e rrugës etj.

Pajisjet e tjera teknike janë aksesore të rëndësishëm për kryerjen e procesve të punës

2.3.10 Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të disponojnë :

Nr	Emërtimi	Sasia	Statusi
1	Impiant Prodhim Betoni	1 copë	Pronësi, me qira ose kontratë furnizimi
2	Impiant Prodhim Inertesh	1 copë	Pronësi, me qira ose kontratë furnizimi

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor

përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Bazuar dhe në preventivin e punimeve, specifikimeve teknike dhe relacionit teknik, kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë ofertues të 1 (një) Impiant për prodhimin e asfaltit, në vetvete nuk është një kriter diskriminues dhe i pamundur për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret është në të drejtën e autoritetit të kërkojë garanci lidhur me mundësitë e operatorëve ekonomik për sigurimin e lëndës bazë dhe materialeve që do të përdoren për realizimin e objektit, përsa kohë lejohet provueshmëria e disponimit nëpërmjet edhe kontratave të furnizimit sikurse autoriteti kontraktor ka përcaktuar në DST, duke e lenë të hapur përmbushjen e këtij kriteri në respekt të plotë të ligjit të prokurimit publik.

Në preventivin e punimeve, autoriteti kontraktor ka parashikuar punime betoni dhe inerte në sasi të mëdha.

Duke pare volume e mëdha të punës që do të kryhen, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij të kërkojë garanci nga ofertuesit për përmbushjen me sukses të çdo zëri të preventivit të punimeve.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

2.3.11 Operatori ekonomik në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates te publikuar në DST, duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë si më poshtë:

- a) Autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori për Hekur Betoni
- b) Autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori për Rjete teli e zinguar për Gabion

Në rast paraqitjeje të autorizimit nga Distributori duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit të autorizuar.

Argumentim : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 8, si dhe”, në bazë të nenit 44, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kjo kërkesë është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe materialet e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kerkuara prodhohen në mënyrë industriale, çertifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të verifikojë që specifikimet teknike të paisjeve të propozuara nga operatorët ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si : çertifikatë/deklaratë konfirmimiteti, çertifikatat e cilësisë ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike.

Kërkesa për dorëzimin e formatit të autorizimit të prodhuesit për produktet e sipërcituara është një kërkesë në përputhje dhe proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës dhe i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor, nuk krijon pengesa të dukshme ose të fshehura për ofertuesit si edhe nuk diskriminon midis operatorëve ekonomikë ofertues vendas dhe të huaj, pasi standartet e kërkuara është Standardi Shqiptar i cili është i harmonizuar me Standardin Europian.

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet dhe furnizimet që parashikohen të realizohen në preventiv, duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve bashkëkohore. Prandaj e gjykojmë të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve europiane, në mënyrë që të provohet që operatori ekonomik ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit.

Me anë të vënies në dispozicion në fazën e ofertimit të dokumentave si autorizim-marrëveshje angazhimi, ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë në përputhje sipas kërkesave të projektit.

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT